



Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No.

424/2014

Data:
Datum:
Date:

05.12.2014

Prishtinë/Priština/Prishtina

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA /
AGENCY OF GENDER EQUALITY

REFERENCË:	424 /2014		
PËR/ZA/TO:	z. Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm ZKM z. Besnik Osmani , Sekretar i Përgjithshëm MPMS z. Murat Meha , Kryeshef Ekzekutiv AKK z. Arben Çitaku , Sekretar i Përgjithshëm MMPH z. Naim Bahtiu , Sekretar i Përgjithshëm MF z. Shpend Ahmeti , Kryetar i Komunës së Prishtinës		
CC:	Znj. Edita Tahiri, Zëvendës Kryeministre RK		
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:	Edona Hajrullahu , Kryeshefe Ekzekutive/ ABGJ		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për emërimin e personave në grupin punues për hartimin e Udhëzimit Administrativ për Regjistrimin e Pronës së Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve		
Nr. i zyrës:	709	Lokacioni:	
Br. kancelarije:		Kucni:	
Room No.:		Extension:	
		Data: Datum: Date:	05.12.2014

Të nderuar

Me datë 15.09.2014 Zv. Kryeministrja e Republikës së Kosovës, Znj. Edita Tahiri ka marrë vendim nr 130/2014 për themelimin e grupit punues për hartimin e Udhëzimit Administrativ për Regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve me përfshirjen e akterëve nga ministritë përkatëse.

Me qëllim të respektimit të vendimit dhe njëkohësisht me qëllim të fillimit të punës së këtij grupi, ju lutemi të caktoni anëtarët kompetent nga institucionet tuaja.

Në vijim gjeni të bashkëngjitur një kopje të shkresës shpjeguese për hartimin e Udhëzimit Administrativ për Regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve dhe vendimin për themelimin të grupit punues.

Ju falënderojmë për bashkëpunim

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Pro/ 130/2014

Data/15.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 4.1 dhe 7 paragrafi 1.6 të Rregullores nr 02/2011, 2.11 dhe 16.6,16.7 dhe 16.8 ,16.9 të Ligjit për Barazi Gjinore Zëvendës-Kryeministrja e Kosovës, nxjerr këtë

V E N D I M

1. Themelohet Grupi punues për hartimin e Udhëzimit Administrativ për “Regjistrimin e Pronës së përbashkët në emrin e të dy bashkëshortëve” në këtë përberje
 - a) Agjencia për Barazi Gjinore – tre përfaqësues
 - b) Zyra e Kryeministrit – Zyra Ligjore – një përfaqësues
 - c) Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - një përfaqësues
 - d) Agjencia Katastrale e Kosovës - një përfaqësues
 - e) Ministria e Planifikimit Hapësinor - një përfaqësues
 - f) Ministria e Financave - një përfaqësues
 - g) Komuna e Prishtinës - Drejtoria Katastrale – një përfaqësues
2. Në cilësinë e ekspertëve dhe me të drejta të barabarta me anëtarët tjerë janë:
 - a) Oda e Noterëve të Kosovës - një përfaqësues
 - b) OJQ që punojnë në fushën e barazisë gjinore - një përfaqësues
3. Agjencia për Barazi Gjinore e kryeson grupin dhe obligohet ta përgadisë draftin final për aprovim në Qeverinë e Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit

Zëvendëskryeministër
e Republikës së Kosovës

Edita Tahiri

Vendimi i dërgohet:

- Të gjithë anëtarve
- Agjencisë për Barazi Gjinore
- Arkivit të Qeverisë

Shkresa spjeguese.
Udhëzimi Administrativ “Regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve”

Barazia Gjinore është një e drejtë themelore në çdo shoqëri demokratike. Qasja e grave në pronë është një faktor i rëndësishëm, i cili është i lidhur drejtpërdrejtë me fuqizimin ekonomik të vajzave dhe grave, e që njëkohësisht ndikon në eliminimin e deformimeve sociale, siç janë diskriminimi dhe dhuna në baza gjinore.

E drejta në pronë, është një e drejtë themelore që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i vendit, si dhe nëpërmjet ligjeve në fuqi si Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Familjen, Ligji i Trashëgimisë, Ligji mbi Pronën dhe Ligji kundër Diskriminimit.

Ligji për Barazinë Gjinore siguron që femrat dhe meshkujt gëzojnë të drejtat në pronësi, respektivisht në regjistrim të pronës dhe trashëgim të pronës, në mënyrë të barabartë.

Ligji për Familjen në dispozitat e tij përcakton shumë qartë të drejtën e bashkëshortëve në pasurinë e palujshme si pasuri e përbashkët dhe garanton të drejtën e regjistrimit të saj në Regjistrin Publik të Pasurive të Palujshme në emër të dy bashkëshortëve.

Edhe pse legjislacioni ynë garanton të drejta të barabarta për burrat dhe gratë, pesha e traditës, mentalitetit, gjendja e dobët ekonomike, si dhe niveli i ulët i arsimimit, flasin kundër një barazie reale, një pabarazi e cila është edhe më e theksuar në zonat rurale të Kosovës.

Në Kosovë sot vetëm 15% e pronës së regjistruarë në emër të gruas duke përfshirë këtu edhe rastet kur ajo është pronare e vetme dhe kjo përqindje është shumë e vogël kur ajo është pronare e pasurisë së përbashkët.

Duke garantuar një qasje të barabartë ndaj pronës dhe shfrytëzimit të saj, ne nxisim barazinë mes dy gjinive, dhe rrjedhimisht ndikojmë në një zhvillim ekonomik më të hovshëm të vendit, pasi vetëm në këtë rrugë do shfrytëzohej potenciali i gjysmës së popullsisë, të cilën e përbën gjinia femërore. Në anën tjetër, përveç ndikimit pozitiv në zhvillimin ekonomik, prona është mjete thelbësor për eliminimin e pasigurisë, si dhe akteve primitive siç është edhe dhuna mbi baza gjinore. Duke u nisur nga kjo, Agjencia për Barazi Gjinore është e angazhuar maksimalisht që të hartojë politika me qëllim të fuqizimit të pozitës së femrës në Kosovë .

Ligji për Barazi Gjinore përcakton masat e përgjithshme dhe të vecanta për garantimin e të drejtave të barabarta dhe lejon Agjencinë për Barazi Gjinore që të ndërmarrë hartimin e masave të vecanta (udhëzim administrativ) si masë afirmative të përkohshme, e cila do të mund të stimulonte edhe bashkëshorten që të regjistronte pronën edhe në emrin e saj.

Qëllimi i rregullativës

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të përcaktoj mënyrën dhe mundësitë stimuluese për regjistrimin e pronës edhe në emrin e gruas si bashkëpronare për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë të saj me burrat në të drejtën e pronës së palujshme si e drejte themelore e njeriut e mbrojtur edhe me Kushtetutën e Kosovës.

Grupi punues do ti shqyrtoj mundësitë edhe në bashkëpunim me Komunat e Kosovës dhe pikat në të cilat do të përqendrohet ky udhëzim administrativ si masa stimuluese do të jenë

- Lirimi nga taksa fillestare e regjistrimit.
- Reduktimi i taksës në prone/ tatimit per vitin e parë , ne rast se prona është e re dhe nuk ka tatim të akumuluar

- Reduktimi i takses së akumuluar të tatimit në pronë

Udhëzimi Administrativ do të ndihmojë në:

- Sigurinë ligjore dhe garantimin e të drejtës së të dy bashkëshortëve për të administruar me pronën Sigurinë që pas regjistrimit prona të jetë objekt qarkullimi dhe pjesë e ekonomisë së tregut ,garanci bankare, etj.
- Fuqizimin ekonomik të gruas në Kosovë.
- Ngritjen e numrit te pronave te regjistruara
- Avancimin e mëtejme të drejtësisë gjinore sipas standardeve ndërkombëtare.
- Iqurimin e Komunave qe pas një viti sa do të jetë në fuqi ky udhëzim do të kenë tatim pagues të garantuar dhe të regjistruar si të tillë.
- Stimulimin e kurorzimeve të çifteve

Fusha e veprimit

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ do të zbatohen në periudhën e caktuar kohore prej 1 viti pas hyrjes në fuqi gjatë të cilës synohet ndryshimi i gjendjes, dhe do të ketë veprim obligimi ndaj;

- Agjencisë Katastrale të Kosovës
- Zyrave Katastrale Komunale
- Agjencisë për Barazi Gjinore
- Noterëve
- Avokatëve dhe
- Ndërmetësuesve

Institucionet përgjegjëse për hartimin e Udhëzimit Administrativ

Institucionet bartëse për hartimin e këtij dokumenti do të jenë:

- Agjencia për Barazi Gjinore, Agjencia Katastrale e Kosovës.
- Zyra e Kryeministrit
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
- Ministria e Drejtësisë.
- Komuna e Prishtinës /Zyra Katastrale.
- Përfaqësues nga Noterët.